

THEMELET SOCIO-INTELEKTUALE TË PËRQASJES SË MALEK BENNABIUT NDAJ QYTETËRIMIT

BADRANE BENLAHCENE



THE SOCIO-INTELLECTUAL FOUNDATIONS OF
MALEK BENNABI'S APPROACH
to **CIVILIZATION**

Seria e librave të përmbledhur të IIIT-së

THEMELET SOCIO-INTELEKTUALE TË
PËRQASJES SË MALEK BENNABIUT
NDAJ QYTETËRIMIT

Themelet Socio-Intelektuale të Përqasjes së Malek Bennabiut ndaj Qytetërimit
(Albanian)
Badrane Benlahcene

Copyright © Center for Advanced Studies and the International Institute of Islamic Thought (IIIT), First Edition 1446AH / 2025CE

ISBN: 978-9928-126-62-7 Paperback

Translated into Albanian from the English Title:
The Socio-Intellectual Foundations of Malek Bennabi's Approach to Civilization /
Abridged by Alison Lake

Copyright © The International Institute of Islamic Thought (IIIT), First Edition
1434AH / 2013CE
ISBN: 978-1-56564-596-7 Paperback

IIIT
P.O. Box 669
Herndon, VA 20172, USA
www.iiit.org

IIIT London Office
P.O. Box 126
Richmond, Surrey
TW9 2UD, UK
www.iiituk.com

PËRKTHIMI	Vehap Kola
KONSULENT SHKENCOR	Ramiz Zekaj
REDAKTIMI SHKENCOR	Ilir Haxhijaj
REDAKTIMI GJUHËSOR	Mariglana Kurtaj
KOORDINATORE	Anisa Hykaj
FAQOSJA	Jilduza dhe Selmir Pajazetovic
DIZAJNI	Muhamed Hasanovic
BOTUES	Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam www.aiitc.net / contact@aiitc.net
SHTYPUR NGA	Shtypshkronja dhe Shtëpia Botuese "Mileniumi i Ri" Autostrada Tiranë-Durrës, km 26 Cel: +355 672063702 email: info@mileniumiri.al web: www.mileniumiri.al

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Në varësi të përjashtimit ligjor dhe dispozitave të marrëveshjeve përkatëse të licencimit kolektiv, nuk lejohet asnjë riprodhim i asnjë pjese, pa lejen me shkrim të botuesve.

Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë libër janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë medoemos edhe ato të botuesit. Botuesi nuk mban përgjegjësi për saktësinë e adresave të jashtme, ose të faqeve të internetit të palëve të treta, të cituara në këtë botim, dhe nuk garanton se përmbajtja e faqeve të tilla është ose do të vazhdojë të jetë e saktë ose e përshtatshme.

.....
CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Bin Laḥasan, Badrān Mas'ūd
Themelet socio-intelektuale të përqasjes së Malek Bennabiut ndaj qytetërimit / Badrane Benlahcene ;
përkth. Vehap Kola ; red. Mariglana Kurtaj. - Tiranë : AIITC, 2025. 45 f. ; 21 cm.
Tit. origj.: The socio-intellectual foundations of Malek Bennabi's approach to civilization.

1.Bennabi, Malek. 2.Qytetërimi islam 3.Lindja dhe Perëndimi

Badrane Benlahcene



THEMELET SOCIO-INTELEKTUALE TË
PËRQASJES SË MALEK BENNABIUT
NDAJ QYTETËRIMIT

Përkthimi
Vehap Kola



Tiranë, 2025



Botimi i këtij libri u mbështet nga Instituti Ndërkombëtar
i Mendimit Islam (IIIT) dhe Qendra për Studime të Avancuara (CNS).



Përmbajtja

Seria e Librave të Përmbledhur të IIIT-së.....	7
Hyrje	9
Kapitulli 1	
Qytetërimi: Koncepte dhe Përqasje.....	14
Kapitulli 2	
Konceptet kryesore të përqasjes së Bennabiut ndaj qytetërimit.....	19
Kapitulli 3	
Interpretimi i Bennabiut për Lëvizjen e Qytetërimit.....	23
Kapitulli 4	
Rrënjët e përqasjes së Bennabiut ndaj civilizimit:	
Përmasa e brendshme shoqërore	31
Kapitulli 5	
Rrënjët e përqasjes së Bennabiut ndaj qytetërimit:	
Përmasa e jashtme-shoqërore.....	35
Kapitulli 6	
Themelet e përqasjes së Bennabiut ndaj qytetërimit:	
Dimensioni i brendshëm intelektual	38
Kapitulli 7	
Themelet e përqasjes së Bennabiut ndaj qytetërimit:	
Përmasa e jashtme-intelektuale	42



Seria e Librave të Përmbledhur të IIIT-së

“Seria e librave të përmbledhur të IIIT-së” është një koleksion me vlerë i botimeve kryesore të Institutit, të shkruara në formë të përmbledhur, projektuar për t’u dhënë lexuesve një kuptim thelbësor të përmbajtjes bazë të origjinalit. Të botuara në një format të shkurtër, të lehtë për t’u lexuar, që kursen kohë, këto seri ndihmëse ofrojnë një përmbledhje të familjarizuar dhe të shkruar me kujdes të botimit të plotë dhe shpresohet se do t’i nxisin lexuesit të eksplorojnë më tej origjinalin.

The Socio-Intellectual Foundations of Malek Bennabi’s Approach to Civilization u botua në formë të plotë në vitin 2011. Që kur u bë publike për herë të parë eseja e Samuel Huntington “Përplasja e qytetërimeve” shqetësimi për qytetërimin dhe konfliktin është risjellë në debatin mbi rendin botëror. Malek Bennabi (1905–1973), mendimtar i shquar algjerian dhe intelektual i madh musliman, u përqendrua me qëllim në zbulimin e shkaqeve të rënies së muslimaneve dhe suksesit të qytetërimit e kulturës perëndimore. Problemi kryesor që ai teorizoi nuk qëndronte në Kuranin apo besimin islam, por te vetë muslimanët. Autori heton qasjen e Bennabiut ndaj qytetërimit dhe parimet themelore të përfuara me anë të

metodologjisë metateorizuese. Duke vepruar kështu, ai hedh më shumë dritë mbi një nga elementët ndoshta më intrigues të teorisë së Bennabiut, se qytetërimi qeveriset nga faktorë të brendshëm - të jashtëm dhe social-intelektualë, dhe se është e mundur që të prodhojmë një ekuacion për vetë qytetërimin. Këtu shpjegohet ekuacioni Njeri + Tokë + Kohë = Qytetërim, ku feja, sipas Bennabiut, përbën katalizatorin më të rëndësishëm, dhe vlerësohet rëndësia e tij për ndalimin e rënien muslimane. Ajo që është qartazi e dukshme është se, për Bennabiun, “Njeriu është forca qendrore në çdo proces qytetëruar dhe, pa të, dy elementët e tjerë nuk kanë asnjë vlerë”.

Për sa i përket rezultateve, bindja e pagabueshme e Bennabiut se, nëse muslimanët nuk ndryshojnë gjendjen e tyre shpirtërore, ata nuk mund të bëjnë ndonjë ndryshim të gjerë e kuptimplotë në shoqëri, jehon në vargun kuranor:

“Vërtet, Allahu nuk do ta ndryshojë gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë brendësinë e tyre”
(13:11).

Botim i Përmbledhur i Originalit të autorit Badrane Benlahcene



Hyrje

Ky libër fokusohet në punën e Malek Bennabiut (1905–1973), mendimtar i shquar algjerian dhe intelektual i madh musliman. Ai sjell njohuri të reja në metodologjinë dhe filozofinë e tij. Bennabiu, veprimtaria studimore e të cilit nxori në pah shkaqet e rënies së botës muslimane dhe suksesin e qytetërimit e kulturës perëndimore, doli në përfundimin se problemet nuk qëndronin në Kuran apo në besimin islam, por te vetë muslimanët. Një panoramë e vërtetë e efekteve të kolonizimit dhe faktorëve që udhëheqin qytetërimin mund të zgjidhë problemet e botës muslimane dhe të nisë një rilindje të re muslimane.

Kjo vepër hulumton përjasjen e Bennabiut ndaj qytetërimit dhe parimeve të përftuara nga zbatimi i metodologjisë së metateorizimit [*Mu*], duke shkuar përtej literaturës ekzistuese, për të prezantuar përjasjen ndërdisiplinare të Bennabiut ndaj civilizimit, dhe analizon strukturën në themel të saj. Ajo nënvizon teorinë e Bennabiut se qytetërimin e udhëheqin faktorë të brendshëm e të jashtëm, socialë e intelektualë dhe që është e mundur që të prodhohet një ekuacion për qytetërimin.

Sipas Bennabiut, feja është katalizatori më i rëndësishëm i ekuacionit: Njeri + Tokë + Kohë = Qytetërim, dhe është e rëndësishme për të përmbysur rënien e botës muslimane. Për

Bennabiun, Njeriu është forca qendrore në një proces qytetërues dhe, pa të, dy elementët e tjerë nuk kanë vlerë.

Besimi i Bennabiut se muslimanët duhet që, së pari, të ndryshojnë gjendjen e tyre shpirtërore përpara se të ndryshojnë me sukses shoqërinë apo civilizimin gjën jehonë në vargun kuranor 13:11: “Vërtet, Allahu nuk do ta ndryshojë gjendjen e një populli derisa ata të ndryshojnë brendësinë e tyre”.

Studimi i qytetërimeve dhe ndryshimit global vijon të mbajë një vend të dukshëm në qarqet akademike. Shumë studiues dhe intelektualë kanë bërë thirrje për rishqyrtimin e veprave të studiuesve kryesorë të qytetërimeve. Bennabi, i pari filozof social dhe sociolog i botës muslimane pas Ibn Khaldunit, u përpoq të zbulonte ligje universale dhe parime themelore, që udhëheqin shoqëritë njerëzore dhe qytetërimet si dhe përcaktojnë fatin e tyre në histori. Shqetësimi i tij për rënien e qytetërimit musliman e çoi atë të analizonte shkaqet e saj dhe të ofronte zgjidhje. Ai theksoi rolin e ideve si katalizatorë për rritjen e qytetërimit pa i kushtuar rëndësi adresimit të dilemës së ekonomisë, politikës dhe ideologjisë.

Me një njohje të thellë të Islamit dhe shkencave shoqërore, Bennabiu iu qas performancës së shoqërive njerëzore dhe dinamikës së kulturës e qytetërimit nga një pikëpamje universale. Synimi i tij ishte që të zgjidhte problemet shoqërore brenda kuadrit të qytetërimit, njësisë së njohshme për studimin e dukurive socio-historike. Ai shprehej se: “Problemi i çdo populli, në thelb, është ai i qytetërimit të tij”.

Filozofia e Bennabiut është një sistem i integruar interpretimi, mbështetur në një të kuptuar të thellë të Islamit. Përjasja e tij në studimin e qytetërimit dhe rrjedhës së tij në histori ndihmon të diagnostikohet kriza qytetërimore muslimane, të shpjegohen burimet dhe zgjidhjet e saj. Formimi i tij shkencor ndërthurur me vështrimin e tij historik, sociologjik dhe filozofik i krijuan mundësinë të analizojë qytetërimin

europian dhe të prodhojë mendim dhe analizë origjinale të pikave të forta dhe të dobëta të *ummetit*.

Ky studim ka si qëllim të përcaktojë faktorët e ndryshëm që ushtruan ndikim mbi përqasjen e Bennabiut ndaj qytetërimit. Këtu shqyrtohen instrumentet, metodat, konceptet dhe teoritë e tij. Gjithashtu analizohet procesi dhe përqasja e tij. Qëllimi final është të kuptojmë qytetërimin bashkëkohor dhe pasojat e tij në jetën shoqërore, si dhe të ofrojmë një kuadër qytetërimor për vendimmarrësit.

Përmes një sistemi gjithëpërfshirës analize, përqasja metateorike e Bennabiut reflekton përpjekjet intelektuale në botën muslimane që prej fillimit të shekullit të nëntëmbëdhjetë, që u orvatën të zgjidhnin çështjen e prapambetjes dhe të rivinin në punë qytetërimin musliman. Përqasja ndërdisiplinare që u përftua, huazon nga filozofia e historisë, shkencat shoqërore dhe trashëgimia e Ibn Khaldunit. Kjo pikëpamje është thelbësore për diagnostikimin e dilemave të ndryshme pjesore në botën muslimane dhe qytetërimet e tjera.

Për një vlerësim më të mirë të konceptit të Bennabiut për qytetërimin, ne zbatojmë përqasjen metateorizuese të George Ritzer, studimi sistematik i strukturës themelore të teorisë sociologjike. Ajo përshtatet në mënyrë më sistematike me kuadrin intelektual dhe kulturor islam, sferën themelore të zhvillimit të ideve të Bennabiut. Autori përdor llojin e parë të metateorizimit (*Mu*). Qëllimi i këtij studimi është të kuptojmë më mirë teorinë e Bennabiut për qytetërimin me katër përmasat e nënllujt të metateorizimit (*Mu*).

Mu përfshin studimin e teorisë për të prodhuar një kuptim më të thellë të teorisë ekzistuese. Përmasa e saj shoqërore e brendshme sheh brenda fushës së studimit dhe fokusohet më shumë në faktorë shoqërorë sesa konjitivë. Përmasa shoqërore e jashtme zhvendoset drejt një niveli makro për të shqyrtuar shoqërinë në tërësi dhe ndikimin e saj mbi teorizimin, ndërsa

thekson marrëdhëniet ndërmjet procesit të teorizimit dhe institucioneve të ndryshme. Te Bennabiut, ky dimension përqendrohet në marrëdhëniet ndërmjet faktorëve shoqërorë të jashtëm dhe formulimit dhe zhvillimit të përqasjes së tij.

Përmasa intelektuale e brendshme përqendrohet në çështjet intelektuale ose konjitive, që tradicionalisht i janë brendashkruar studimit të qytetërimit. Ajo përfshin përpjekje për të identifikuar paradigmat kryesore konjitive, shkollat e mendimit, ndryshimet paradigmatiche dhe zhvillimin e instrumenteve metateorike. Përmasa intelektuale e jashtme u kthehet disiplinave të tjera akademike për ide, instrumente, koncepte dhe teori për studimin e qytetërimit. Në rastin e Bennabiut, kjo përmasë përfshin ndikimin e Kuranit, mendimit fetar në botën muslimane, filozofinë, psikologjinë, shkencat natyrore dhe veprimtari të tjera intelektuale jashtë fushës së studimeve të qytetërimit dhe dy paradigmeve të tij mbizotëruese.

Mu ofron metoda sistematike për të kuptuar, vlerësuar, kritikuar dhe përmirësuar teoritë ekzistuese. Metateoricienët studiojnë në mënyrë sistematike grupe të hollësishme, shpesh të krahasuara të teorive sociologjike. *Mu* lejon një vlerësim dhe analizë kritike më të saktë të teorive ekzistuese.

Metoda krahasimore e këtij studimi përdor modelin *Mu* për të kuptuar përqasjen e Bennabiut ndaj civilizimit dhe për të krahasuar përqasjen e tij me Ibn Khaldunin dhe të tjerët. Ky studim përdor një qasje të metodave të përziera, duke kombinuar analizën historike, analizën krahasimore dhe analizën e përmbytjes. Përmes krahasimit, autori synon të kuptojë dhe zbulojë dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet përqasjeve të Bennabiut dhe të tjerëve. Metoda e analizës së përmbytjes trajton konceptet, premisat dhe terminologjinë e Bennabiut për të kuptuar shprehjet e tij, për të zbuluar strukturën themelore të përqasjes së tij dhe për të shqyrtuar konceptimet e ndryshme të tij, si një sistem për një të kuptuar të thelluar, me ndihmën e

“Seria e librave të përmbledhur të IIIT-së” është një koleksion me vlerë i botimeve më të rëndësishme të Institutit shkruar në një formë të kondensuar për t’i dhënë lexuesit një të kuptuar thelbësor të përmbajtjes kryesore të origjinalit.

Studiuesi dhe intelektual i njohur algjerian Malek Bennabi (1905-1973) kishte interes në nxjerrjen në dritë të shkaqeve të rënies muslimane dhe arsyet e suksesit dhe arritjeve të qytetërimit perëndimor. Problemi kryesor që ai teorizoi nuk qëndron në Kuran apo në besimin islam por në vetë muslimanët.

Ky studim hulumton përqasjen e Bennabiut ndaj qytetërimit duke përdorur metodologjinë e metateorizimit për të shqyrtuar tezën e tij, dhe për të hedhur dritë më shumë mbi njërin prej elementëve, me gjasë, më intrigues të teorisë së tij, që qytetërimi udhëhiqet nga faktorë të brendshëm-të jashtëm dhe socialë-intelektualë, dhe se mund të prodhohet një ekuacion për vetë qytetërimin.

Ky ekuacion i Njeriut + Tokës + Kohës = Qytetërim, për të cilin feja formon katalizatorin e pazëvendësueshëm, është analizuar dhe është vlerësuar rëndësia e tij në termat e një përmbysjeje të rënies muslimane. Ajo që është qartësisht e dukshme është se për Bennabiun, Njeriu është forca qendrore në cilindo proces qytetërues dhe pa të dy elementët e tjerë nuk kanë ndonjë vlerë.

Sa u përket rezultateve, bindja e pagabueshme dhe e palëkundur e Bennabiut se nëse muslimanët nuk ndryshojnë gjendjen e tyre shpirtërore nuk mund të ndikojnë mbi asnjë ndryshim domethënës dhe me ndikim të gjerë në shoqëri gjen jehonë në vargun kuranor: “Vërtet, Allahu nuk do ta ndryshojë kurrë gjendjen e një populli derisa ata të ndryshojnë brendësinë e tyre” (13:11).

BADRANE BENLAHCENE është profesor i asociuar i studimeve të qytetërimit dhe filozofisë së historisë, Departamenti i Filozofisë, Universiteti i Batnas në Algjeri, dhe Departamenti i Studimeve Islame, Fakulteti i Arteve, Universiteti King Faisal, në El-Ahsa të Arabisë Saudite. Ai është ekspert i veprës së Bennabiut, pasi ka botuar artikuj në një sërë revistash dhe ka paraqitur punime mbi Bennabiun dhe studimet e qytetërimit në konferenca në Algjeri, Marok, Arabinë Saudite dhe Malajzi.



ISBN 978-9928-126-62-7



Mu-së. Është përdorur edhe spektri mikro-makro, një instrument epistemologjik për trajtimin e botës së ndërlikuar shoqërore.

Burimet kryesore të këtij studimi për analizimin e kuadrit teorik të Bennabiut dhe përqasjes së tij ndaj qytetërimit janë veprat origjinale të Bennabiut, i cili i botoi të gjithë librat e tij nën një titull, *Mushkilāt el-Ḥaḍārah* dhe vepra të tjera mbi sociologjinë dhe degët e saj të shumta, filozofinë e historisë, antropologjinë, historinë dhe shkencat e tjera shoqërore. Autori përdor edhe vepra të tjera si burime dytësore.



Kapitulli 1

Qytetërimi: Koncepte dhe Përqasje

Përqasja ndërdisiplinare është më produktive për teorinë dhe kërkimin mbi qytetërimin, ngase ajo mbulon të gjitha aspektet e dukurisë në fjalë. Kur hulumtohet zhvillimi i konceptit të “qytetërimit” dhe përqasjeve ndaj çështjeve të tij përgjatë historisë, ajo ndihmon të identifikohen paradigmat dhe shkollat mbizotëruese në fushën e studimeve qytetërimore.

Përcaktimi se si koncepti i qytetërimit lindi nga traditat e ndryshme kulturore dhe gjuhësore në qytetërimet të ndryshme është sfidues, veçanërisht në traditat perëndimore dhe muslimane. Po aq e vështirë është polemika mbi përkufizimet e ndryshme që u janë përcaktuar fushave të ndryshme të qytetërimit. Shumica e studiuesve pajtohen se qytetërimet janë entitete më të gjera kulturore. Huntington, i cili e vendos qytetërimin në kontekstin e historisë dhe zhvillimit gjatë gjithë kohës, kombinon gjithashtu qytetërimin me fenë, një karakteristikë qendrore e qytetërimit, siç bënë Ibn Khaldun, Toynbee, Bennabi dhe studiues të tjerë të qytetërimit.

Islami dhe Profeti Muhamed (pqmt)¹ ndryshuan themelet e marrëdhënieve shoqërore në shoqërinë fisnore arabe, në një

1 *(pqmt) – ‘Paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të’, e shqiptuar sa herë përmendet emri i Profetit Muhamed.

kulturë civile islame të bazuar në ide, që kombinonte shtresa shoqërore dhe grupe etnike të ndryshme. Si themelues i një shoqërie dhe qytetërimi të ri, Profeti Muhamed kuptoi se zhvillimi urban duhet të zëvendësojë një kulturë nomade dhe fisnore. Qyteti i tij i Medinës ishte bërthama e transformimit të qytetërimit.

Termi “qytetërim” u shfaq për herë të parë në traditat kulturore muslimane në veprat e shekullit të katërmëdhjetë të Ibn Khaldunit. Ai futi në përdorim termat *Ḥaḍārah* dhe *‘Umrān*, të krahasueshme me termin perëndimor “qytetërim” dhe *‘Ilm al-‘Umrān* (“shkenca e qytetërimit”). Ibn Khalduni e shihte qytetërimin si një gjendje të domosdoshme ku njerëzit banojnë dhe qëndrojnë së bashku. Koncepti i tij qëndron në themel të karakterit dinamik të fenomenit në rrjedhën e zhvillimit njerëzor.

Koncepti i qytetërimit u zhvillua më tej në mesin e intelektualëve muslimanë në fund të shekullit të 19-të me ringjalljen islame dhe përballjet e para me Europën moderne. Koncepti *ḥaḍārah* fitoi popullaritet në mesin e qarqeve shkencore dhe intelektuale në botën arabe dhe Bennabiu ishte pionieri në përzgjedhjen e tij për të treguar “qytetërimin”. Në gjuhë të tjera të botës muslimane përdorej termi *medenije* ose derivatet e tij.

Pikëpamjet muslimane dhe perëndimore pajtohen për sa u përket elementëve rudimentarë të qytetërimit: vendbanimet urbane, rendi ose organizimi dhe jetesa sedentare. Fjalët e ndryshme të gjuhëve për qytetërimin tregojnë se ai përmban shoqërinë urbane, një formë qeverisjeje, një formë shkrim-leximi, aftësinë e njerëzve për të transformuar mjedisin dhe jetën e tyre, funksione të specializuara, një rrjet marrëdhëniesh shoqërore dhe një sistem besimi dhe koncept të Zotit ose të një qenieje më të lartë.

Pavarësisht marrëveshjes së gjerë mbi cilësitë kryesore të qytetërimeve, ka dallime në pikëpamje, metodologji, fokus dhe

koncepte. Përjasje të ndryshme shihen brenda paradigmeve dominuese të filozofisë, historisë dhe shkencave sociale me nën-paradigmat e tyre të antropologjisë dhe sociologjisë. Ky prezantim ofron një kornizë për të kuptuar çështjen e qytetërimit në përgjithësi dhe konceptimin e Bennabiut në veçanti.

Filozofia e historisë u shfaq si një përpjekje për t'i dhënë shpjegime racionale ngjarjeve. Përderisa historia është një studim i “rendit të parë” i veprimeve, ngjarjeve dhe situatave të së kaluarës, filozofia e historisë është një studim i “rendit të dytë”: studimi i studimit të këtyre temave. Mund të konsiderohet një “meta” studim, që nuk merret drejtpërdrejt me ngjarje, veprime dhe situata. Përkundrazi, ky studim indirekt kërkon të shpjegojë dhe shtjellojë përgjigjet për të kaluarën. Filozofët e historisë ndjekin pikëpamje gjithëpërfshirëse të procesit të historisë.

Historianët kërkojnë të përshkruajnë të kaluarën, arsyet përse shoqëria ndryshon, rolin e aktorëve dhe providencës në histori dhe modelet universale në lëvizjet historike. Disa shkolla të mendimit kanë theksuar praninë e vullnetit hyjnor, ndërsa të tjera lartësojnë rolin e individit ose të forcave ekonomike dhe forcave të tjera jopersonale në procesin historik. Në një përjasje progresive ndaj historisë, Platoni, Herderi, Hegeli dhe shumë mendimtarë të tjerë europianë i shihnin pikëpamjet judeo-kristiane për kohën dhe historinë si përparim në një vijë të drejtë, të kombinuar me nocionin klasik të cikleve historike.

Në mungesë të një skeme konceptuale të pranuar përgjithësisht, që mund të siguronte një kornizë uniteti, ata që u përpoqën të shkruanin historinë botërore kanë përdorur tri qasje: modelin e serive (sekuencës) të kulturave ose qytetërimeve, në të cilat të gjitha kulturat (qytetërimet) i nënshtrohen të njëjtit model zhvillimi; modeli i progresit; dhe historitë e thjeshta paralele të popullsive të ndryshme të njerëzimit. Modeli sekuencial është më i zhvilluari dhe ka

dalë nga veprat e dijetarëve të mëdhenj të qytetërimit, si Ibn Khalduni.

Krahasuar me paradigmen tradicionale të filozofisë së historisë dhe qasjet e saj të ndryshme ndaj qytetërimit, paradigma e shkencave sociale është ende në momentet e lindjes së saj. Antropologjia ishte shkenca e parë sociale që u angazhua me studimin e qytetërimit dhe kulturës njerëzore. Qytetërimi, në traditën antropologjike, është gjendja më e lartë e kulturës dhe identiteti më i gjerë kulturor.

Sociologët i qasen historisë nga një tjetër këndvështrim. Sociologjia historike nuk synon kryesisht të ndërtojë modele zhvillimore të proceseve të strukturuar të ndryshimit. Ajo përqendrohet te historia, ndërsa shqyrton aspektet sociale të ngjarjeve, fakteve ose institucioneve historike. Në këtë kontekst, qytetërimi, si një fenomen në shkallë të gjerë dhe një proces historik e evolucionar afatgjatë i zhvillimit, i përket makro-sociologjisë. Sikurse historianët dhe filozofët e historisë, makro-sociologët besojnë se mund të kuptojnë proceset më themelore të ndryshimit në jetën e njeriut në periudha më të gjera kohore të analizës.

Problemet më urgjente të kohës sonë shihen gjithnjë e më shumë si makro-sociologjike dhe kërkojnë teori dhe kërkime makro-sociologjike si zgjidhje. Shumë probleme dhe zhvillime mikro-sociologjike nuk mund të kuptohen ose trajtohen përveçse në një kontekst të prirjeve më të gjera shoqërore. Makro-sociologjia, me fokusin e saj në njësitë e analizës, ka kontribuar në studimin e fenomeneve në shkallë të gjerë duke analizuar proceset afatgjata, sistemet kulturore, shoqëritë dhe qytetërimin.

Sociologjia e ndryshimit ka kontribuar në studimin e qytetërimit dhe ndryshimit historik duke kategorizuar nivelet e ndryshimit bazuar në një variabël të vetëm: madhësia (familja, shoqëria, kultura, qytetërimi, bota); periudha (historike,

afatgjatë, afatshkurtër); ose aspekti (kulturator, intelektual dhe qytetërimor).

Paradigma e shkencave sociale e qendërzuar në mënyrë empirike ka shmangur më shumë pyetje teorike dhe filozofike. Literatura ka demonstruar një nevojë metodologjike për studim ndërdisiplinar të qytetërimit dhe një shqyrtim sistematik të kompleksitetit të tij. Konceptet e ndryshme të "qytetërimit" mund të ndihmojnë në shqyrtimin e karakterit të tij të shumanshëm dhe qasjeve aktuale të papërshtatshme. Dështimi i qasjeve të tjera për të menaxhuar në mënyrë gjithëpërfshirëse studimin e qytetërimit sugjeron që qytetërimi nuk mund të studiohet në mënyrë të përshtatshme në nivele të ndryshme në një mënyrë të izoluar, por duhet të konceptohet në një perspektivë globale.



Kapitulli 2

Konceptet kryesore të përqasjes së Bennabiut ndaj qytetërimit

Bennabiu kritikonte tendencat reformiste dhe moderniste në botën moderne muslimane për anashkalimin e shkaqeve të krizës dhe përqendrimin vetëm te simptomat. Ai vlerësonte se përpjekjet për të ndezur një rilindje në botën muslimane nuk prodhuan një përqasje sistematike ndaj krizës. Problemi ishte i rrënjësor në kulturën muslimane të epokës post-*muvahide* dhe Bennabiu shprehej se procesi historik hapi shtigjet kolonizimit. Ky i fundit nuk është arsyeja kryesore për situatën aktuale në botën muslimane, por lehtësia jonë për t'u kolonizuar është një prej faktorëve të shumtë dytësorë.

Përkufizimet e Bennabiut për qytetërimin janë të ndryshme. Ai pranonte se qytetërimi aktivizon kapacitetet shoqërore për t'u përballur me problemet vendimtare të një shoqërie dhe vinte në dukje ekuilibrin ndërmjet aspekteve morale e materiale në jetën e njeriut. Meqenëse shoqëria justifikon aktivitetet njerëzore në sferën e historisë, shoqëria është forca thelbësore në çdo proces qytetëruës.

Bennabiu pohonte se faktorët moralë dhe materialë janë thelbësorë për të krijuar ekuilibër dhe gjallëri në shoqërinë

njerëzore. Gjithashtu ata prodhojnë solidaritet dhe unitet. Ai e përkufizonte qytetërimin përmes strukturës dhe thelbit shoqëror: "...qenia njerëzore mëson se si të jetojë brenda një grupi dhe percepton... rëndësinë thelbësore të rrjetit të marrëdhënieve shoqërore në organizimin e jetës njerëzore, në mënyrë që të kryejë funksionin dhe përgjegjësitë e tij historike".

Për Bennabiun, formula "Qytetërimi = Njeri + Tokë + Kohë" përfaqësonte ekuacionin e qytetërimit, i cili përcakton në mënyrë strukturore elementët ose përbërësit e tij. Këta elementë bazë të çdo veprimi apo produkti qytetërimor tregojnë se problemi i qytetërimit zbërthehet në tri kategori: njeriu, toka dhe koha.

Bennabiu shprehej se të gjitha objektet ose gjërat që njerëzit prodhojnë rezultojnë nga njeriu (*Insān*), dheu (*Turāb*) dhe koha (*Uaqt*). Tre elementët që gjenden në çdo shoqëri janë themelet që ajo të fillojë një proces civilizimi. Vetëm kur e trajtojmë shkencërisht ndërtimin e personalitetit njerëzor, shfrytëzimin e tokës dhe organizimin e kohës, qytetërimi do të sigurojë shërbimet e nevojshme sociale dhe ndihmën që u nevojitet njerëzve për zhvillim. Në këtë ekuacion, njeriu (*Insān*) është elementi kryesor i qytetërimit dhe forca qendrore në çdo proces qytetëruës. Bennabiu kritikonte lëvizjen reformiste në botën muslimane për përpjekjen e saj për të reformuar mjedisin dhe jo faktorin njerëzor. Ai argumentonte se ne duhet të reformojmë njeriun dhe se qytetërimi ngrihet me llojin e integruar të njeriut, që i shndërron karakteristikat e tij në ideale që të përmbushë rolin e tij në shoqëri.

Koncepti i orientimit (*teuxhīh*), sipas Bennabiut, i referohet harmonisë në lëvizjen e një qytetërimi, unitetit në objektiva dhe shmangies së konfliktit ndërmjet përpjekjeve që nisin nga të njëjtat burime dhe synojnë objektiva të ngjashme. Bennabiu e shihte kulturën si faktorin parësor, që ndikonte njeriun si personalitet shoqëror dhe shoqërinë si trup kolektiv. Forma e kulturës përcakton drejtimin e qytetërimit dhe fatin e tij në histori.

Në ekuacionin e Bennabiut, feja është thelbësore për të organizuar dhe drejtuar të tre elementët drejt procesit të tyre qytetërues. Të gjithë qytetërimet në histori kanë lulëzuar pa përjashtim mes ideve fetare. Megjithatë, në qasjen e Bennabiut, feja nuk mund të fillojë funksionin e saj civilizues si katalizatore, nëse nuk nis një proces qytetërues që përbashkon njeriun, tokën dhe kohën në një projekt. Ai argumentonte se qytetërimet bashkëkohore formuluan sintezën origjinale dinamike të njeriut, tokës dhe kohës në djepin e një ideje fetare.

Bennabiu trajton origjinën dhe natyrën e sferave të shoqërisë, ku përbërësi i çdo veprimi përkon në një prej tri kategorive: objekteve, individëve dhe ideve. Zbatimi i mekanizmit të sintezës në këto elementë na bën të ditur se të gjitha veprimet, veprimtaritë dhe punët janë shumatore e njerëzve, materialeve ose instrumenteve dhe ideve pas këtyre veprimeve. Arritja e qytetërimit varet nga tërësia e veprimtarisë që rezultojnë nga shumatorja e të gjitha aktiviteteve të kryera nga njeriu.

Në rrafshin e individit, qytetërimi e fillon procesin e tij me një individ të transformuar, të integruar në aktivitetet e shoqërisë. “Sfera e individëve” te Bennabiu shënon shumatoren e marrëdhënieve, konstruktive ose shkatërrimtare, midis një grupi të caktuar, dhe thekson rëndësinë e këtyre marrëdhënieve. Rrjedhimisht, fati i shoqërisë në procesin e saj civilizues bazohet në natyrën ose cilësinë e marrëdhënieve në atë sistem të formuar nga sfera e individëve.

Sipas Bennabiut, sfera e ideve përbëhet nga ide të injektuara, që rrjedhin nga burime të shenjta ose laike dhe funksionon si një model, që orienton dhe udhëheq shoqërinë drejt disa vlerave dhe një etike të caktuar. Në qytetërimin musliman, idetë e injektuara rrjedhin nga Kurani dhe Suneti. Bennabiu e konsideronte qytetërimin rezultat të një ideje të gjallë, dinamike, që mobilizon një shoqëri të para-civilizuar për

të hyrë në histori dhe për të ndërtuar një sistem idesh sipas arketipave të saj.

Sfera e ideve i jep shoqërisë vizion dhe modele origjinale për të formuluar qytetërimin e saj dhe formon një prototip, që mund ta ndjekin të gjithë individët në një shoqëri, duke dalluar kulturën. Sfera e ideve është e rëndësishme që shoqëria të marrë një rol konstruktiv në histori. Sfera e objekteve ofron mjete, kanale, burime natyrore dhe instrumente të nevojshme për procesin e qytetërimit. Ajo përmbush nevojat materiale për lëvizjen historike të shoqërisë dhe shpreh pozicionin e shoqërisë në procesin e saj qytetërues.

Bennabiu pohonte se asnjë aktivitet historik nuk mund të ekzistojë midis këtyre sferave pa “rrjetin e marrëdhënieve shoqërore”, një koncept i lidhur fuqimisht me kuptimin e tij për natyrën dhe dinamizmin e shoqërisë nga perspektiva socio-kulturore dhe historike. Marrëdhënia dialektike midis tri sferave shënon dhe nënkupton ekzistencën e rrjetit të marrëdhënieve shoqërore. Kjo sferë siguron marrëdhëniet minimale të nevojshme midis tri sferave për çdo veprim historik që përpiket të ndërtojë një qytetërim. Të tri sferat nuk mund të funksionojnë pa rrjetin e marrëdhënieve shoqërore.

Meqenëse Bennabiu ishte i interesuar kryesisht për mënyrën se si të rindërtohej shoqëria muslimane, të ringjallte kulturën e saj dhe ta pastronte atë nga elementet negative të trashëguar nga epoka e rënies së saj, ai theksonte nevojën për “sociologjinë e pavarësisë”. Zanafilla e asaj sociologjie të re është ripërcaktimi i “shoqërisë”. Ai linte të kuptohej se ndërsa shoqëria natyrore është një shoqëri statike, shoqëria historike është dinamike. Gjithashtu argumentonte se disa karakteristika janë të përbashkëta për të gjitha llojet e shoqërisë historike. Rrjeti i marrëdhënieve shoqërore lidh anëtarët e shoqërisë dhe drejton aktivitetet për të përmbushur një funksion të përbashkët, që është misioni dhe vokacioni specifik i asaj shoqërie.



Kapitulli 3

Interpretimi i Bennabiut për Lëvizjen e Qytetërimit

Bennabiu e shikonte ciklin e qytetërimit si “një seri numerike, që ndjek rrjedhën e saj në terma të ngjashëm, por jo identikë,” duke sugjeruar që qytetërime të veçanta janë ciklike dhe ndjekin një rrjedhë të ravijëzuar. Çdo grup shoqëror gdhend karakteristikën e tij specifike në qytetërim dhe çdo qytetërim ka një identitet të veçantë. Qytetërimet ndryshojnë në kushtet e tyre specifike psiko-kohore, por janë të ngjashme në modelin e tyre të përgjithshëm në histori.

Bennabiu pohonte se qytetërimi fillon ciklin e tij kur elementët e tij themelorë sintetizohen brenda kornizës së idesë fetare, dhe përfundon kur ato elemente themelore nuk janë më në një ndërveprim dinamik. Çdo qytetërim luan rolin e tij në histori, derisa të bjerë dhe të pushojë së zhvilluari dhe udhëhequri njerëzimin. Një qytetërim tjetër fillon të formulojë nga e para ciklin e tij në histori. Ky proces kalimtar i qytetërimit justifikon dukurinë ciklike në histori.

Bennabiu argumentonte se çdo shoqëri në procesin e saj civilizues do të ndjekë një model të përcaktuar, që çon

në një transformim qytetërues. Pas përfundimit të fazës së paraqytetërimit, një shoqëri në fazën e dytë (faza e qytetëruar) do t'i nënshtrohet tri fazave: shpirtit (shpirtërores), arsyes (racionales) dhe instinktit (instinktives).

Nocioni ciklik mund të trajtojë problemet sociale duke përcaktuar pozicionin tonë në ciklin e historisë, si dhe duke kuptuar shkaqet e rënies dhe potencialin për përparim. Koncepti i ciklit mund të shpjegojë lëvizjen e qytetërimit dhe është kuadri konceptual themelor për të analizuar dhe kuptuar ekzistencën shoqërore njerëzore. Bennabiu, i cili e zhvilloi këtë ide nga Ibn Khalduni, sugjeronte që qytetërimi njerëzor zë fill nga një pikë e caktuar dhe ndjek një model të përcaktuar. Në fazën përfundimtare, vlerat e qytetërimit kalojnë dhe mbarten në një vend tjetër. Ky tranzicion provon ekzistencën e një cikli.

Bennabiu besonte se tri fazat e ciklit nuk janë zhvendosje spontane nga një situatë në tjetrën, por pasqyrojnë transformime dhe modifikime të thella të njerëzve dhe shoqërisë. Rrethana të jashtëzakonshme janë të nevojshme për të prodhuar sintezën organike historike të tre faktorëve: njeriu, toka dhe koha. Kjo sintezë shënon lindjen e një shoqërie, pasi ajo përkon me fillimin e veprimit të saj historik. Në këtë pikë, vlerat sociale nuk janë ende realitet konkret.

Në fillim të çdo qytetërimi, një ide fetare mbjell farën për të çelur lëvizjen e një qytetërimi. Më pas, faza shpirtërore fillon të dominojë jetën e individit dhe të shoqërisë. Gjatë kësaj faze, individ i dezintegruar do të kthehet në një individ të integruar, atëherë kur rrjeti i marrëdhënieve shoqërore është më i dendur. Ky proces kushtëzimi i organizon instinktet në një raport funksional me kërkesat e idesë fetare. Individ angazhohet në jetë, në këtë gjendje të re, bazuar në ligjet e Shpirtit.

Rrjeti i marrëdhënieve shoqërore arrin gjendjen e tij të përsosur, ndërsa ideja e tij fetare vazhdon të zgjerohet. Në të njëjtën kohë, qytetërimi mund të përballet me probleme dhe

nevoja të reja, duke krijuar një rend të ri dhe standarde të reja. Më pas, faza shpirtërore dobësohet me zhvillimin e shoqërisë, ngritjen e problemeve materiale dhe zgjerimin e qytetërimit, duke e çuar qytetërimin në fazën e dytë (racionale). Arsyeja kontrollon të gjitha aktivitetet, ndërsa qytetërimi vijon të përparojë në histori. Ndërkohë që qytetërimi kalon në fazën racionale, shoqëria gëzon rrjetin e saj të marrëdhënieve të zhvilluara mirë, por vuan nga disa defekte. Në aspektin psikologjik, individit nuk ka më kontroll të plotë mbi energjinë e tij jetësore gjatë kryerjes së funksioneve të tij shoqërore. Një pjesë e forcave dhe energjive të shoqërisë kanë rënë në pasivitet dhe të tjerat kanë pushuar.

Gjatë gjithë historisë së një qytetërimi, procesi i evolucionit të tij manifestohet në psikologjinë e individit dhe në strukturën morale të shoqërisë, e cila pushon së rregulluari sjelljen individuale. Kur forcat racionale fillojnë të humbasin kontrollin mbi aktivitetet e individit, qytetërimi përballet me një kontekst të ri, ku forcat instinktive dominojnë ato shpirtërore dhe racionale. Qytetërimi futet në fazën e pasqytetërimit dhe vlerat e tij kalojnë në një sintezë të re të njeriut, tokës dhe kohës. Në këtë fazë të tretë, rrjeti shoqëror shpërbëhet dhe idetë fetare ose shoqëria nuk i kontrollojnë më instinktet individuale. Kaosi dhe paligjshmëria mbizotërojnë. Instinktet çlirohen gradualisht, ndërsa kontrolli i shpirtit dobësohet në mënyrë graduale.

Kur instinktet çlirohen plotësisht, fati i njeriut bie nën ndikimin e tyre, fillon faza e tretë e qytetërimit dhe ideja fetare pushon së përmbushuri funksionin e saj shoqëror. Për rrjedhojë, shoqëria shpërbëhet dhe shënon fundin e një cikli qytetërimi. Kur pushon frymëzimi i shpirtit, edhe puna racionale priret të ndalet.

Bennabiu argumentonte se qytetërimet janë cikle të ndërlydhura, që zënë fill me një ide fetare dhe përfundojnë kur forcat instinktive dominojnë forcat shpirtërore dhe racionale. Ai

besonte se ky cikël i plotë qytetërimi me tri fazat e tij shënonte energjinë jetike të qytetërimit dhe mënyrën e transformimit të tij nga një fazë në tjetrën. Njohja e çdo faze të evolucionit të qytetërimit dhe kuptimi i karakteristikave të tij do të na sigurojë një kornizë të përgjithshme zhvillimi dhe evolucionit.

Bazuar në kategorizimin e shoqërive nga Bennabiu, një shoqëri njerëzore nuk e rregullon veten në një moment të jetës së saj. Përkundrazi, ajo kalon nga një situatë në tjetrën, duke ndjekur vlerat psiko-sociale të zhvillimit të saj. Kësisoj, njohja e pozicionit të shoqërisë në boshtin zhvillimor është e domosdoshme për të identifikuar stadin e asaj shoqërie, problemet e lidhura me të dhe arritjet përkatëse.

Në boshtin që përfaqëson fazat e zhvillimit, një shoqëri historike zë një vend specifik, shprehej Bennabiu. Historia zbulon ekzistencën e tri fazave: shoqëria e para-qytetëruar, shoqëria e qytetëruar dhe shoqëria e pas-qytetërimit. Në çdo moment, secila shoqëri ndodhet në një nga këto tri faza specifike dhe dallohet nga vlera specifike. Bennabiu përqendrohej në histori, sociologji dhe psikologji për metodologjinë e të kuptuarit të çështjeve të qytetërimit. Ai përdorte interpretimin psikosocial për shpjegimin e udhëtimit historik të një shoqërie, me qëllim që të zbulonte tiparet e botës së sotme muslimane.

Bennabiu e shihte individin në shoqërinë e para-civilizuar si njeriun natyror (*homonatura*), i cili është gati, si beduini arab gjatë epokës së Profetit Muhamed, të hyjë në një cikël qytetërimi. Një shoqëri e para-civilizuar ka nevojë për një forcë shtytëse, për të nxitur tiparet qytetëruese. Edhe pse shoqëria zotëron elementët parësorë të qytetërimit (njeriu, toka dhe koha), ato janë të palëvizshme pa forcën e idesë fetare. Pa ndërveprimin dinamik midis njeriut, tokës dhe kohës brenda kornizës së idesë fetare, shoqëria nuk do të ndërmarrë procesin e saj civilizues dhe as do të dëshmojë ndonjë transformim psiko-social.

Zhvillimi psiko-social i individit dhe shoqërisë do të lejojë një lëvizje civilizuese, sepse kapacitetet e shoqërisë kanë

për qëllim një projekt social. Kur shoqëria e civilizuar fillon të ndryshojë veten për të arritur qëllimet e saj, nis të shfaqet qytetërimi i saj. Faza e qytetëruar pasqyron aftësinë e një shoqërie për të organizuar dhe formuluar botëkuptimin dhe kulturën e saj. Kur njeriu përgatitet të nisë një proces qytetërues, rrjeti i marrëdhënieve shoqërore është në kulmin e fuqisë së tij. Në këtë kontekst, shoqëria mund të mbrojë qytetërimin dhe të mbajë ritmin e saj të zhvillimit. Të gjithë individët në këtë fazë gëzojnë mbrojtjen e shoqërisë dhe kjo e fundit përmbush funksionin e saj civilizues.

Kur shoqëria arrin fazën e pasqytetërimit, ajo nuk është më dinamike dhe humbet kapacitetet e saj civilizuese, duke nisur rënien. Kështu ideja fetare pushon së sintetizuari vlerat qytetëruese dhe rrjeti i marrëdhënieve shoqërore degjeneron. Megjithatë, rënia nuk është e parathënë. Një veprim tjetër qytetërues mund ta pengojë shoqërinë nga ky fat dhe të ndryshojë trajektoren e saj të rënies. Pasi shoqëria ka humbur kornizën e saj kulturore, sfera e saj e ideve hyn në një gjendje kaosi dhe kultura e saj resht së qeni civilizuese. Bennabiu vinte në dukje pështjellimin rreth fazave dhe keqkuptimin e karakteristikave të tyre midis studiuesve. Ngatërrimi i fazave do të komplikojë çdo përpjekje për të zgjidhur problemet e një shoqërie.

Bennabiu u përpoq të gjente zgjidhje për problemet e situatës aktuale në botën muslimane, duke e parë atë në fazën e tretë, ku shoqëria ka humbur mendimin ose sjelljen origjinale, në krahasim me fazat e tjera. Për të zgjidhur problemet e saj, shoqëria duhet të rifitojë origjinalitetin dhe sjelljen dinamike duke krijuar një njeri të ri, i cili është i çliruar nga karakteristikat e njeriut të pasqytetëruar. Më pas, ai mund të hyjë në një sintezë të re me kohën dhe tokën dhe të përfshijë një ide fetare. Bennabiu argumentonte nevojën për të njohur fazën tonë të historisë dhe shkaqet e prapambetjes ose zhvillimit. Problemet sociale janë historike: ajo që është e përshtatshme për një

shoqëri në një fazë të caktuar të zhvillimit të saj mund të jetë e dëmshme në një fazë tjetër.

Po ashtu, Bennabiu i përqaset evolucionit të shoqërisë nga perspektiva psiko-sociologjike dhe paraqiste konceptin e tri epokave psiko-sociologjike të zhvillimit të shoqërisë: epoka e objekteve, epoka e njerëzve dhe epoka e ideve. Ai prezantoi një koncept të përgjithshëm të marrëdhënies dialektike midis sferave të individëve, objekteve (gjërave) dhe ideve që i jep kuptim konceptit të tri epokave. Bennabiu pohonte se çdo shoqëri ka universin e saj kulturor kompleks, ku sferat e objekteve, individëve dhe ideve janë të ndërthurura me veprimin e bashkërenduar të shoqërisë. Një sferë është gjithnjë superiore mbi dy sferat e tjera.

Shoqëria në epokën e saj të parë formulon gjykimet dhe vendimet e saj, sipas kriterëve të vendosura nga sfera e objekteve. Natyra dhe cilësia e gjykimeve i nënshtrohen nevojave primitive të njeriut dhe e vendosin atë në fushën e objekteve. Bennabiu argumentonte se shoqëria njerëzore përjeton epokën e objekteve në fazat e para-qytetërimit dhe të pasqytetërimit. Në shoqërinë e sotme muslimane, ajo ndikon në nivelet psikologjike, morale, sociale, intelektuale dhe politike. Në nivelet psikologjike dhe morale, kur kultura përqendrohet tek objektet, “objekti” qëndron në krye të peshores së vlerave, gjykimi do të jetë sasior dhe jo cilësor dhe gjithçka do të gjykohet nga peshorja e objekteve, jo vlerave.

Në epokën e dytë, shoqëria i formon gjykimet sipas standardeve të një modeli apo shembulli njerëzor, që buron nga sfera e individëve dhe jo e objekteve. Në këtë epokë, sfera e objekteve dhe e ideve duhet të shoqërojë sferën e individëve. Bennabiu e prezantonte shoqërinë *xhahīle* (arabe para-islame) si një shembull i ideve të centralizimit në sferën individuale, e cila ishte e mbyllur brenda kufijve fisnorë. Në shoqërinë aktuale muslimane ekziston një ndërlidhje midis despotizmit të

objekteve dhe individëve, për të cilin Bennabiu argumentonte se është i dëmshëm veçanërisht në nivelet morale dhe politike.

Ky autor besonte se koncepti i tri epokave është një instrument i rëndësishëm për të matur lëvizjen e shoqërisë në rrjedhën e historisë, si dhe për të matur vlerat kryesore të shoqërisë në një moment specifik, për të kuptuar nëse shoqëria është në ngritje apo rënie. Veprimi i shoqërisë duhet parë si një veprimtari e integruar, ku sfera e objekteve përzihet me sferën e individëve dhe atë të ideve. Një sferë dominon gjithnjë dy të tjerat, duke bërë një shoqëri të dallueshme nga tjetra, për sa i përket mendimit dhe sjelljes.

Koncepti i tri epokave mund të përdoret si një metrikë për të matur pjekurinë psikosociale të një shoqërie, drejtimin e procesit të saj civilizues, organizimin e aktiviteteve të saj dhe transferimin e vlerave nga një fazë në tjetrën gjatë historisë. Për më tepër, dominimi i një sfere mbi dy të tjerat tregon se ku ndodhet shoqëria në lëvizjen e saj historike. Epokat përfaqësojnë vlerat shoqërore dhe mjedisin kulturor, që dominojnë dhe ndikojnë mbi shoqërinë në çdo moment të zhvillimit të saj.

Bennabiu e vendoste botën muslimane në fazën e paraqytetërimit, ku ajo lufton për të hyrë në një proces të ri qytetërues. Ai e interpretonte lëvizjen e qytetërimit përmes niveleve të ndryshme të analizës për një kuptim gjithëpërfshirës të procesit dinamik të qytetërimit në histori. Konceptet e tij për ciklin, tri fazat dhe tri epokat janë një analizë shumë-niveloze e dukurisë.

Zhvillimi i shoqërisë në procesin e saj civilizues regjistrohet në mënyrë cilësore dhe sasiore, pohonte Bennabiu, në rrjetin e saj të marrëdhënieve shoqërore, që shënon fazat e shoqërisë në rrjedhën e historisë së saj. Ai argumentonte se çdo proces qytetërues fillon përpara se të zhvillohen tri sferat e tij. Formimi i sferës së individëve është parakusht për formulimin e rrjetit të marrëdhënieve shoqërore. Shoqëria funksionon, porsferat e ideve dhe objekteve janë ende rudimentare. Më

pas, sfera e individëve ndryshon dhe integrohet në rendin e ri të marrëdhënieve. Rrjeti i marrëdhënieve sociale zë të funksionojë, ndërsa dy sferat e tjera të ideve dhe objekteve janë ende të papjekura.

Sfera e ideve luan rolin e mbrojtësit social, ndërsa është e lidhur fort me rrjetin e marrëdhënieve sociale. Një shoqëri fillon rindërtimin, i cili është i pamundur pa rrjetin e marrëdhënieve sociale. Sfera e ideve nuk mund të justifikojë e vetme zhvillimin ose dekadencën e një qytetërimi. Përkundrazi, ajo duhet të integrohet me rrjetin e marrëdhënieve sociale. Historia e një shoqërie nuk është gjë tjetër, veçse historia e rrjetit të marrëdhënieve të saj shoqërore, të krijuara fillimisht nga një ide fetare.



Kapitulli 4

Rrënjët e përqasjes së Bennabiut ndaj civilizimit: Përmasa e brendshme shoqërore

Duke përdorur përkufizimin e Ritzer-it për dimensionin e brendshëm shoqëror, ky kapitull fokusohet në ndikimin e këtyre faktorëve në qasjen e Bennabiut. Skica biografike e Bennabiut është e rrallë dhe autobiografia e tij mbulon periudhën nga lindja e tij në 1905-ën deri në 1939-ën. Burime të kufizuara që mbulojnë pjesën tjetër të jetës së Bennabiut plotësohen nga librat e tij, shkrimet e bashkëkohësve dhe të dhënat historike të kohës së tij.

Malek Bennabi lindi në vitin 1905, në një familje të varfër në Algjerinë Lindore. Mjedisi islam, që formoi personalitetin e tij, mbrojti edhe muslimanët algjerianë kundër shtypjes koloniale mbi kulturën dhe qytetërimin e tyre.

“Tregimet e përshpirtshme të gjyshes së tij po formësonin në mënyrë të pandërgjegjshme personalitetin tim dhe, teksa i dëgjoja, e dija se bekimi është në zenitin e vlerave dhe etikës islame”.

Nën sundimin francez, ai u bë dëshmitar i një migrimi kolektiv të shumë familjeve vendase, përfshirë të afërmit e tij,

nga Algjeria, në vendet arabe lindore. Kjo protestë ndaj sundimit kolonial ndryshoi në mënyrë dramatike strukturën sociale dhe ekonomike të Algjerisë. Mjedisi tradicional islam degjeneroi, jeta tradicionale u shtur dhe ekzistenca kolektive ishte në rrezik. Bennabiu e kuptonte rëndësinë e marrëdhënieve shoqërore në nivelin mikro të familjes dhe në nivelin makro të shoqërisë.

Në komunitetin e Bennabiut, *zāuijeh*, një institucion tradicional, luajti një rol vendimtar në ruajtjen e mësimave islame pas rënies së qytetërimit musliman, ashtu si edukimi dhe letërsia zyrtare arabe. Rrëfyesit ruajtën kulturën popullore, ndërsa xhamia dhe medreseja, luajtën një rol vendimtar në edukimin e Bennabiut. Ai mësoi gramatikën, letërsinë, poezinë arabe, jurisprudencën dhe teologjinë.

Në librin e tij të parë, Bennabiu riinterprettoi temat kryesore të Kuranit dhe përpunoi teoritë e tij në fusha të ndryshme sociale dhe kulturore. Teza e tij qendrore mbi fenë i priu analizës së tij të thelbit dhe rolit të saj në çdo proces qytetërues. Për Bennabiun, feja është e ngulitur në rendin universal si një ligj që karakterizon shpirtin njerëzor. Bennabiu e zbuloi Islamin në perspektivën e tij universale, kur më vonë takoi shumë mendimtarë dhe aktivistë muslimanë në Francë. Ai e konsideronte Islamin fe, mënyrë jetese, gjenerator shoqëror, kulturë dhe qytetërim.

Problemi i arsimit në botën muslimane ishte një problem thelbësor që e shqetësonte Bennabiun. Vizioni, metodologjia, mjetet dhe funksioni mungonin, veçanërisht në Algjeri nën sundimin kolonial shtypës. Dy sisteme arsimore ngulitën në mendjen dhe shpirtin e tij kërkimin e arsyeve të dekadencës së sistemit tradicional dhe përparimit të sistemit modern (francez dhe perëndimor) të arsimit.

Ndërsa i pari ishte në një gjendje të tmerrshme, i dyti po gjente shtrirje. Ky zotëronte metodologji të zhvilluara dhe një vizion të qartë, gjithashtu kishte fituar edhe mbrojtjen e regjimit

kolonial. Megjithatë, vizioni i tij i sekularizuar dhe misioni përëndimor kundërshtonin kuadrin qytetërimor musliman, një dikotomi që mori vëmendjen e Bennabiut gjatë gjithë jetës dhe karrierës së tij.

Bennabiu vëzhgoi dhe regjistroi ndryshimet që po ndodhnin në jetën dhe mendimin si në shoqëritë europiane, ashtu edhe në ato algjeriane muslimane. Këto dy kontekste ndikuan në konceptet e tij lidhur me njeriun e natyrës dhe njeriun e qytetërimit. Ai përjetoi prirje të reja mendimi në qarqet intelektuale muslimane. Lëvizja e *ulemave* ishte e paprecedentë në shoqërinë algjeriane në përqasje dhe metodë, për sa u përket reformave të shoqërisë.

Sfondi i Bennabiut si qytetar i një Algjerie të kolonizuar, student në dy sisteme arsimore dhe komunikimi me kolonizatorët europianë formësuan idetë e tij për të kolonizuarit dhe kolonizatorin dhe konceptin e “potencialit për kolonizim”, si një mjet për të analizuar situatën psikologjike të muslimaneve të sotëm.

Njohuritë e Bennabiut për mendimin europian ngritën vetëdijen e tij intelektuale dhe politike. Interesi i tij u zhvendos nga inxhinieria në filozofi dhe shkenca shoqërore, dhe më pas në mendimin reformist musliman, lëvizjen për dekolonizim dhe përpjekjet e ripërtëritjes në Algjeri dhe në botën muslimane. Ai e kuptoi rëndësinë e lëvizjes së *ulemave* në Algjeri dhe propagandoi idetë e *işllāh* (reformës) dhe të Magribit (Afrika e Veriut). Bennabiu ishte i impresionuar nga lëvizja reformiste e *ulemave* për një shoqëri të lirë dhe të pavarur algjeriane, derisa ata ia dorëzuan udhëheqjen shoqërore politikanëve. Ai besonte në epërsinë e aktiviteteve arsimore dhe kulturore mbi aktivizmin politik.

Si refugjat politik në Egjipt, Bennabiu krijoi lidhje me intelektualë dhe institucione tradicionale, duke ndikuar tek intelektualët arabë që të fokusoheshin në çështjet e ripërtëritjes

qytetëruese dhe rilindjes në *umetin* musliman. Bennabiu vdiq në Algjeri në vitin 1973, duke lënë trashëgiminë e mendimtarit më të madh musliman, që Algjeria ka prodhuar ndonjëherë në kohët moderne.

Lidhjet e Bennabiut u përcaktuan nga *Mu* në dimensionin e tij të brendshëm-shoqëror. Ai besonte në punën në ekip dhe lidhjet e forta me intelektualët muslimanë dhe botës në zhvillim, për të gjetur zgjidhje për çështjet e ndërlikuara të moszhvillimit. Lidhjet e tij më të forta ishin me lëvizjen reformiste në botën muslimane të përfaqësuar nga *ulematë*.

Besnikëria e Bennabiut ndaj Islamit dhe admirimi për Ibn Khaldunin përcaktuan analizën e tij për kompleksin e inferioritetit të intelektualëve muslimanë ndaj kulturës perëndimore. Ai shprehej se intelektualët e kulturës tradicionale (*ulematë*) nuk mund të përmbushnin misionin e tyre të rëndësishëm në histori, për shkak të kornizës së epokës *el-muvahide*. *Ulematë* u përqendruan në pastërtinë dhe ruajtjen e mësimëve islame dhe u kujdesën të ndryshonin shpirtrat dhe mendësitë nga kultura e tyre *post-muvahide* në një kulturë të re.

Bennabiu u ndikua nga disa dijetarë dhe autorë të hershëm muslimanë si Ibn Tejmije, Ibn Khalduni dhe Ibn Abdulvehabi, dhe e konsideronte veten produkt të atij zinxhiri reformatorësh. Pas përvojës së tij në vende të tjera arabe, ai e zgjeroi analizën e tij duke përfshirë ide të tjera fetare dhe shqyrtoi shpjegimet e ndryshme të fenomeneve shoqërore dhe rolin e fesë në ndryshimet historike.



Kapitulli 5

Rrënjët e përqasjes së Bennabiut ndaj qytetërimit: Përmasa e jashtme-shoqërore

Sipas përqasjes metateorizuese, faktorët e jashtëm socialë fokusohen në analizën e nivelit makro dhe trajtojnë aspektet objektive. Ata hetojnë institucionet dhe rrënjët historike të mendimit. Këta faktorë shënojnë një dimension të *Mu-së*, që zhvendoset në nivelin makro, për të parë shoqërinë e gjerë dhe ndikimin e saj në zhvillimin e teorizimit. Dimensioni i jashtëm social thekson marrëdhënien ndërmjet procesit të teorizimit dhe institucioneve të ndryshme, strukturave të shoqërisë dhe veprimtarive të tjera shoqërore, që kanë lidhje të drejtpërdrejta ose të tërthorta me zhvillimin e përqasjes ose teorisë.

Bennabiu synonte të zgjidhte problemet e qytetërimit musliman në kontekstin e kolonizimit dhe dekolonizimit, duke përdorur sociologjinë për të kuptuar kontekstin e gjerë socio-historik. Ai besonte se kolonializmi ishte pjesë e gjithë agjendës civilizuese të Perëndimit dhe kishte nevojë për një përgjigje qytetërimore nga brenda.

Shkencat perëndimore të antropologjisë, arkeologjisë dhe sociologjisë ndihmuan në garantimin e misionit të pretenduar

qytetërimor për qytetërimin e indigjenëve, barbarëve dhe primitivëve. Këto terma u përdorën për të treguar popujt dhe qytetërimet e kolonizuara. Ai ndoqi dikotominë e dallimit mes tij dhe të tjerëve, duke imponuar shtrirje dhe dominim nëpërmjet standardeve të huaja. Ai i ndau njerëzit dhe i copëtoi vendet muslimane sipas vijave etnike dhe gjuhësore, duke rrezikuar, në mos duke shkatërruar, unitetin e *ummetit*.

Shoqëria algjeriane e epokës parakoloniale ishte në fazën e saj të pasqytetërimit. Sociologjikisht, ajo ishte e qëndrueshme dhe me zhvillim më të lartë se gjatë gjithë epokës koloniale. Algjeria gëzonte një jetë harmonike, stabilitet politik, përparim ekonomik, krijimtari kulturore, harmoni sociale dhe shkrimlexim. Ulematë e saj përhapën arsimin dhe mësimet islame dhe ruajtën identitetin algjerian.

Për fat të keq, zhvillimi dhe prosperiteti nuk zgjatën. Lëvizja koloniale kaloi nëpër katër faza të rëndësishme, që lanë gjurmë në brezat e ardhshëm të shoqërisë algjeriane. Faza e pushtimit dhe e rezistencës (1830-1848) filloi me një politikë “pushtimi të kufizuar” nga Franca. Kjo politikë kishte për qëllim të izolonte algjerianët nga rezistenca dhe të ndryshonte strukturën e tyre sociale, politike, ekonomike, kulturore dhe fetare.

Faza e dytë e rezistencës dhe përshkallëzimit kolonial (1847-1871) e ndau Algjerinë dhe i nënshtroi algjerianët autoktonë. Kolonizimi total dhe faza e pranimit lokal (1871-1919) i shtypi më tej muslimanët algjerianë dhe zgjeroi popullsinë e kolonëve. Në fazën e zgjimit algjerian (1919-1962), kolonizimi arriti kulmin e tij, ndërkohë që midis intelektualëve dhe politikanëve vendas u shfaqën reformizmi dhe ringjallja pan-islamiste.

Së fundmi, thirrja e fuqishme e Islamit, i cili gjatë shekujve u dha algjerianëve një ndjenjë identiteti kolektiv, u mobilizua sërish në vitet 1920 dhe 1930. Gjatë fazës së katërt të kolonizimit, konflikti midis banorëve vendas dhe sundimit kolonial arriti kulmin.

Nga këndvështrimi i Bennabiut, Algjeria kishte qenë në gjendje kaosi për tre shekuj, krahasuar me historinë e lavdishme dhe standardet e qytetërimit islam. Aspektet e brendshme dhe të jashtme të këtij kaosi formojnë dialektikën e potencialit për t'u kolonizuar dhe kolonializmit. Për Bennabiun, kolonializmi kontribuoi në kaos me praninë e tij të drejtpërdrejtë në të gjitha sferat e jetës. Për të përmbushur objektivat koloniale, veçanërisht në botën muslimane, kolonializmi synonte t'i jepte fund çdo procesi qytetërues, duke krijuar një dikotomi artificiale midis pjesëve të shoqërisë.

Si kundërpërgjigje, u zhvillua nacionalizmi algjerian nën përpjekjet e dyfishta të *ulemave* në nivelin intelektual-fetar dhe politikanëve në nivelin politik, duke demonstruar marrëdhënien midis paradigmës së Bennabiut dhe dy nënparadigmave të dekolonizimit: reformistes dhe modernistes.

Bennabiu gjykonte se, për të zgjidhur problemet e kolonizimit dhe potencialit për t'u kolonizuar duhet të zgjidhim çështjet themelore në bazë të gjithë krizës, duke filluar nga një kornizë integruese. Paradigma qytetërimore e Bennabiut do të analizonte gjendjen njerëzore dhe ndryshimet shoqërore brenda kuadrit të qytetërimit, si një kornizë krahasimore.



Kapitulli 6

Themelet e përqasjes së Bennabiut ndaj qytetërimit: Dimensioni i brendshëm intelektual

Ky studim diskuton faktorët e brendshëm-intelektualë, që formojnë dimensionin e tretë të metateorizimit në nënlojin e tij *Mu*. Ai e lidh studimin e faktorëve konjitivë me fushën e qytetërimit dhe është i brendashkruar fushës së studimit të Bennabiut për zgjidhjen e problemeve në botën muslimane. Ai identifikon paradigmat kryesore konjitive, shkollat e mendimit, ndryshimet paradigmatiche dhe instrumentet e përgjithshme metateorike për të analizuar teoritë ekzistuese dhe për të zhvilluar të reja.

Dy paradigma të mëdha kanë dominuar në studimin e qytetërimit: filozofia e historisë dhe shkencat shoqërore. Bennabiu e konsideronte studimin e qytetërimit një fushë më vete, metodologjia dhe konceptet e së cilës rrjedhin nga shkencat sociale. Me njohuritë e tij për Kuranin dhe studimin e feve, ai mund të shmange konceptet materialiste dhe sekulare të dijes dhe të ndryshimeve historike. Përdorimi i dimensionit të brendshëm-intelektual të *Mu*-së në këtë studim ndihmoi në

zbulimin e vetëdijes së Bennabiut për paradigmën mbizotëruese në studimin e qytetërimit.

Ky kapitull zbaton analizën e përmbajtjes për të gjurmuar disa ide të mendimtarët origjinalë. Analiza e paradigmave mbizotëruese dhe shkollave të këndvështrimeve të ndryshme vendos lidhje midis koncepteve, termave dhe metodave të Bennabiut dhe origjinës së tyre në fushat përkatëse dhe shkollave mbizotëruese të mendimit gjatë jetës së tij dhe përgjatë historisë së disiplinës.

Brenda paradigmes së filozofisë së historisë, tri shkolla marrin pjesë në studimin e qytetërimit me paradigmën e tyre të ndërlidhura: pikëpamja ciklike, pikëpamja progresit dhe pikëpamjet e thjeshta paralele të popujve të ndryshëm të njerëzimit. Paradigmat formojnë pikëpamjet kryesore të ndryshimit historik në gjendjen njerëzore dhe shkollat kryesore, që i janë qasur çështjes së qytetërimit, duke shquar dhe konceptuar rregullsi në ndryshimin historik.

Shkolla e progresit historik e shekullit të nëntëmbëdhjetë, me Hegelin, Komten dhe Marksini si studiues kryesorë të saj, e shihte historinë si progresive dhe kontribuoi në studimin e qytetërimit nga Bennabiu. Në metodën dialektike të Hegelit, historia është rrugëtimi progresit të qytetërimit dhe lirisë njerëzore. Marksi, figura tjetër udhëheqëse në shkollën e progresit historik, u frymëzua nga mendimi i Hegelit. Ndërsa Hegeli përdorte dialektikën e mendjes, Marksi përdorte dialektikën e mjeteve ekonomike.

Indikuar nga progresi, Komte zbatoi teorinë e evolucionit të Darvinit dhe zhvillimin e shkencave fizike në gjendjen njerëzore dhe ndryshimet historike. Kontributi kryesor i kësaj shkolle në kuadër të këtij hulumtimi është shpjegimi i lëvizjes historike, fazat dhe shkaqet e saj.

Bennabiu vlerësonte se shumica e historianëve janë përjekur të mbledhin ngjarje historike, në vend që të zhvillojnë

një kornizë për interpretimin racional të këtyre ngjarjeve. Ai vërente një lidhje midis nocionit hegelian të kontradiktës ose dialektikës dhe idesë marksiste, se shkaqet kontradiktore që gjenerojnë ndryshime shoqërore janë ekonomike. Bennabiu i pranonte idetë e hegelianëve si katalizatorë të ndryshimit dhe i vlerësonte marksistët për analizën e tyre dialektike. Bennabiu gjykonte se teoria e Marksit për nevojat njerëzore nuk mund të shpjegojë dinamikën e lindjes së një qytetërimi.

Bennabiu kritikonte shkollën e progresit historik se ishte më shumë teorike sesa historike, si dhe për bazën e saj eurocentrike. Kjo shkollë ishte përqendruar në disa variabla të ndryshimit historik dhe neglizhonte kompleksitetin e qytetërimit si një fenomen shumëplanësh. Ai u ndikua më tej nga shkolla ciklike, prej të cilës Ibn Khaldun dhe Toynbee ishin studiuesit kryesorë. Bennabiu e shihte veten si pasues të qasjes dhe metodologjisë së saj. Kjo shkollë shquante rregullsitë në ndryshimin historik dhe i konceptonte këto rregullsi si ciklike. Studiuesit arritën të rregullsitë universale të ndryshimit historik, pas shqyrtimit të të dhënave të historianëve.

Në veprën *Mukaddime*, Ibn Khalduni nisi një hulumtim të historisë, për të zbuluar ligjet dhe modelet e saj. Studimi i tij mbi natyrën e shoqërisë dhe ndryshimet shoqërore e shtyu atë të zhvillonte atë që ai e quajti *'Ilm el 'Umrân*, shkencën e qytetërimit, ku brezat dhe proceset kontribuojnë në drejtimin e një qytetërimi. Koncepti i tij i *'Aṣabijjeh* është forca që motivon ndryshimin historik në ngritjen, rritjen dhe shpërbërjen e dinastive dhe shteteve.

Toynbee e shihte historinë botërore si një sekuençë qytetërimesh. Këto të fundit ai i konsideronte si rezultat i sfidës dhe përgjigjes dialektike, fazave të rritjes dhe rënies. Ai theksonte natyrën e qytetërimit si njësi “e tërë” ose e njohshme e studimit të ndryshimeve historike. Ashtu si Ibn Khalduni, ai ishte një determinist, që konceptoi një proces qytetërues që duhet të përfundojë me prishjen dhe rënien e qytetërimit.

Shumë studiues pajtohen se Bennabiu është Ibn Khalduni i dytë me idetë, metodën dhe interesin tij. Të dy nocionet e shkakësisë në histori dhe cikli i qytetërimit tërhoqën vëmendjen e Bennabiut. Ai besonte se nocioni i lëvizjes ciklike lejon diskutimin e kushteve të zhvillimit progresiv dhe faktorëve të rënies. Bennabiu e kapërceu gjendjen e Ibn Khaldunit si njësi e njohshme e studimit socio-historik për të përdorur qytetërimin si njësi të studimit historik. Edhe përdorimi i qytetërimit nga *Toynbee* si njësi e analizës historike, nocioni i tij i ciklit dhe formulimi i sfidës dhe përgjigjes patën ndikim në qasjen e Bennabiut.

Bennabiu përdorte metodologjinë e shkencave shoqërore për të analizuar ngjarjet shoqërore të kohës së tij dhe për të diskutuar rolin e fesë në procesin qytetëruar. Për Bennabiun, sociologjia dhe psikologjia ishin të nevojshme për të ndezur një rilindje muslimane. Ai e shihte fenë si sintetizuesin e vlerave shoqërore dhe katalizatorin e qytetërimit për të hyrë në një ndërveprim dinamik. Bennabiu e shihte njeriun si mjetin parësor të qytetërimit që nismon ndryshimin. Ai ishte i pakënaqur me dy paradigmat mbizotëruese të filozofisë së historisë dhe shkencave shoqërore, tri shkollat dhe përqasjet e ndryshme në studimin e qytetërimit.



Kapitulli 7

Themelet e përqasjes së Bennabiut ndaj qytetërimit: Përmasa e jashtme-intelektuale

Dimensioni i katërt i *Mu*-së në qasjen metateorizuese përfshin faktorët e jashtëm-intelektualë, si një alternativë ndaj disiplinave të tjera akademike për idetë, instrumentet, konceptet dhe teoritë në analizën e teorisë. Dimensioni i jashtëm-intelektual përqendrohet në ndikimin e shkencave dhe fushave të kërkimit që tradicionalisht konsiderohen të jashtme për studimet e qytetërimit. Në rastin e Bennabiut, ky dimension i jashtëm-intelektual përfshin ndikimin e Kuranit dhe Sunetit, mendimit reformist fetar në botën muslimane, psikologjisë, shkencave natyrore, filozofisë dhe aktiviteteve të tjera intelektuale jashtë studimit të qytetërimit dhe dy paradigmat mbizotëruese tradicionale të tij.

Bennabiu prodhoi një ekzegjezë dhe interpretim kuranor bazuar në zbulimet dhe zhvillimet moderne shkencore në shkencat shoqërore. Në shpjegimin e konceptit ciklik të ndryshimit historik, Bennabiu iu referua Kuranit për të shpjeguar funksionin e idesë fetare në procesin qytetërues dhe besueshmërinë e parimit kuranor në histori. Ai mori në

shqyrtim faktin se si feja transformon personalitetin njerëzor dhe drejton procesin qytetërues.

Motoja e Bennabiut ishte ajeti kuranor: “Vërtet, Allahu nuk do ta ndryshojë kurrë gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë brendësinë e tyre”. Ai përfshin analizën e statusit të njeriut dhe dominimin e faktorit njerëzor në ndryshimin historik dhe ndryshimin e gjendjes njerëzore. Bennabiu pohonte se për të nisur një proces qytetërues, shoqëria duhet të ndryshojë statusin e një njeriu nga gjendja e tij natyrore e papërpunuar, në një individ të kultivuar.

Parimet kuranore na ndihmojnë të kuptojmë ndryshimin historik dhe rolin e fesë në këtë proces, ndërsa hetimi historik ndihmon në vërtetimin e parimeve kuranore dhe ofron prova empirike. Bennabiu kundërshtonte mendimin modernist ose frymën sekulare, që i mohon fesë çdo rol aktiv në qytetërimin njerëzor. Ai u përpoq të provonte se Kurani dhe Shpallja, siç thuhet në mësimet e të gjithë profetëve, janë një pjesë integrale e qytetërimit njerëzor.

Për të zgjidhur problemin e prapambetjes në botën muslimane, ne duhet të marrim parasysh modelet e përhershme të historisë të përmendura në Kuran dhe të shpjeguara nga Ibn Khalduni në nocionet e tij ciklike të ndryshimit historik, rregullsive universale dhe ligjeve në histori. Kurani dhe Suneti, në kontekstin e *Mu-së*, ishin faktorët kryesorë të jashtëm intelektualë, që ndikuan në përqasjen e Bennabiut në studimin e qytetërimit.

Mendimi reformist në botën muslimane përvetësoi idetë e *işllāh*, *texhdīd* dhe *nahḍah*, shenjat dalluese të asaj lëvizjeje (reforma, përtëritja dhe rilindja). Ato ishin shprehja e një paradigme të re, që u shfaq në mesin e shekullit të 18-të. Lëvizja e Ibn Abdulvehabit u përpoq të ringjallte botëkuptimin origjinal dhe themelor të Islamit, ku ideja e njësimi ankron të gjitha parimet e tjera dinamike. El-Afgani, udhëheqësi tjetër

i mendimit reformist në botën muslimane, i përkiste të njëjtës paradigmë reformiste, duke deklaruar se mësimet e pastra të Islamit ishin të nevojshme që çdo rilindje apo reformë të ketë sukses. Bennabiu adoptoi idetë themelore të asaj lëvizjeje në aspektet e saj intelektuale.

Në Algjeri reformistët nuk iu qasën prapambetjes nga një pikëpamje gjithëpërfshirëse. Bennabiu iu drejtua psikologjisë për një qasje sistematike, duke dashur të kuptonte sesi personaliteti njerëzor mund të ndryshojë dhe të zhvillojë së bashku me objektivin e arritjes së procesit qytetërues. Atij i duhej të kuptonte se si idetë fetare hyjnë në sintezën e vlerave shoqërore dhe lartësojnë vizionin njerëzor.

Bennabiu mbështeste Frojdin dhe Jungun, në lidhje me pozicionin dhe funksionin e fesë, duke përfshirë psikologjinë e zhvillimit nga Piaget. Bennabiu shkroi se ideja fetare e çliron shpirtin njerëzor nga ligji i instinkteve dhe e nënshtron atë ndaj ligjit të shpirtit. Feja drejton sjelljen e individit drejt fuqive të tij/saj jetike dhe i mundëson shoqërisë të ndërmarrë veprimtari të përbashkëta. Frojdi e ndihmoi Bennabin të kuptonte rolin psiko-kohor të fesë në ndryshimin e anës së brendshme të personalitetit njerëzor dhe në drejtimin e fuqive jetësore të individëve dhe grupeve drejt një roli pozitiv në procesin qytetërues.

Kur ideja fetare që drejton procesin qytetërues humbet rolin e saj dinamik, procesi qytetërues i shoqërisë degeneron dhe ndalet së punuari në unison me idenë ose arketipat e saj. Megjithatë Bennabiu përftoi konceptin e fazave kryesisht nga Ibn Khalduni, ai aplikoi psikologjinë moderne të zhvillimit për të analizuar përparimin psikosocial të shoqërisë. I ndikuar nga Piaget, ai nënvizonte se individ dhe shoqëria duket se i nënshtrohen po atyre tri fazave historike: epoka e objektit, epoka e personit dhe epoka e idesë.

Filozofia është faktori i katërt intelektual, që ndikon në qasjen e Bennabiut ndaj qytetërimit. Filozofia, mendimi

kartezipan dhe ligjërimit i modernitetit ishin burimet e tij të jashtme, duke përfshirë idetë e Ibn Tufejlit, Daniel Defoe, Ibn Rushdit dhe Gazaliut. Një nga huazimet më të rëndësishme të Bennabiut nga Dekarti ishte metoda e tij analitike. Ai aplikoi dy mekanizma analitikë të ndryshëm, por të lidhur ngushtë, për të studiuar elementët strukturorë të qytetërimit dhe funksionin e këtyre elementeve në procesin qytetërues.

Bennabiu ishte një nga teoricienët e paktë që trajtoi qytetërimin si një fenomen me shumë aspekte. Kontributi i tij mund të konsiderohet një zhvillim i rëndësishëm dhe një alternativë ndaj paradigmave tradicionalisht të fragmentuara dhe kontradiktore. Bennabiu është i rëndësishëm si një ndërtues sistemi dhe teoricien i qasjes ndërdisiplinare.

Faktorët e jashtëm-socialë e ndihmuan Bennabiun të përcaktojë pikën e tij të nisjes në studimin e qytetërimit. Shqetësimi i tij për situatën në Algjeri dhe në botën muslimane gjatë kohës së tij e shtyu atë të formulonte qasjen e tij për një zgjidhje adekuate të problemeve të ndryshme, me të cilat përballë shoqëria e tij dhe *ummeti*. Në nivelin metodologjik, Bennabiu zbatoi metodat e historianëve, ndërsa në nivelin intelektual dhe njohës, ai integroi dhe huazoi nga disiplina të ndryshme, për të shqyrtuar tri dimensionet kryesore të qytetërimit: historik, social dhe kulturor.

Faktorët e jashtëm intelektualë përfshinin Kuranin dhe Sunetin, mendimin reformist fetar në botën muslimane, psikologjinë, shkencat natyrore, filozofinë dhe aktivitete të tjera intelektuale jashtë fushës së studimit dhe dy paradigmat dominuese tradicionale.

Duhet të vihet më shumë theksi në përqasjen ndërdisiplinare për studimin e qytetërimit që formuloi dhe zhvilloi Bennabiu, dhe për adoptimin e qasjes metateorizuese në studimin e formulimit dhe zhvillimit të ideve, qasjeve, teorive dhe fushave të kërkimit për potencialin e tij për të ofruar një kuptim gjithëpërfshirës të gjenezës dhe zgjerimit të dijes.

